



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AUTORITETI I KONKURENCËS
KABINETI

Njoftim Për Shtyp

Rasti: Rasti i përfimit të kontrollit të shoqërisë DiaVita SHPK nga shoqëria Diaverum International AB.

Pranë Autoritetit të Konkurrencës është depozituar njoftimi në lidhje me transaksionin e përfimit të kontrollit të shoqërisë DiaVita SHPK nga shoqëria Diaverum International AB.

Veprimtaria e palëve pjesëmarrëse:

Blerësi: **Diaverum International AB**, është një shoqëri me përgjegjësi të kufizuar e krijuar sipas legjislacionit të Suedisë, me aktivitet pronësinë dhe administrimin e aksioneve dhe letrave me vlerë dhe aktivitete të tjera të ngjashme me to. Diaverum International AB është pjesë e grupit Diaverum S.a.r.l, e cila ofron shërbime në kujdesin e veshkave dhe shërbimeve të lidhura me to, duke mos prodhuar apo tregtuar vetë pajisjet e dializës ose mjetet një përdorimesh mjekësore.

Diaverum nuk e ushtron aktivitetin e saj në Shqipëri.

Shitësit:

Evita SHPK, është një shoqëria me përgjegjësi të kufizuar, e themeluar sipas legjislacionit të Shqipërisë me NIPT L31714005J. Evita SHPK zotëron 85% të aksioneve të shoqërisë target Dia Vita SHPK.

American Hospital SHA, është një shoqëria me përgjegjësi të kufizuar, e themeluar sipas legjislacionit të Shqipërisë me NIPT K61821002C. American Hospital SHA zotëron 15% të aksioneve të shoqërisë target Dia Vita SHPK.

Target: **DiaVita SHPK**, është një shoqëri me përgjegjësi të kufizuar, e themeluar sipas legjislacionit të Shqipërisë. Objekt i aktivitetit të kësaj shoqërie është zbatimi i kontratës së koncesionit/PPP "Për shërbimin e hemodializës pranë spitaleve rajonale në Shkodër, Lezhe, Korçe, Vlore dhe Elbasan".

Transaksioni:

Më datë 25 Qershor 2019, është nënshkruar "Marrëveshja për shitblerjen e aksioneve", midis palës blerëse Diaverum International AB dhe shitësve American Hospital SHA e cila zotëron 15% të kapitalit dhe Evita SHPK e cila zotëton 85% të kapitalit të shoqërisë DiaVita SHPK.

Transaksioni do të sjellë përfitimin nga Diaverum International AB të 100% të kuotave të DiaVita SHPK, një shoqëri që ofron shërbimet e hemodializës për pacientët me sëmundje të veshkave në Shqipëri nëpërmjet pesë qendrave të kujdesit të shëndetit.

Nga shqyrtimi i dokumentacionit, rezulton se transaksioni i njoftuar është në përputhje me nenin 10 dhe 12, të Ligjit. Për këtë arsye ky transaksion i është nënshtruar procedurës së njoftimit të përqendrimit duke plotësuar Formularin e Njoftimit të Përqendrimit.

Si pasojë ky transaksion është objekt autorizimi nga Komisioni i Konkurrencës.

Autoriteti fton palët e interesuara të shprehin opinionet e tyre për transaksionin e njoftuar.

Opinionet mund të dërgohen pranë Autoritetit të Konkurrencës me fax (Nr. 0355 4 2234 497), me postë në adresën: Autoriteti i Konkurrencës, Rr. “Sami Frashëri”, Nr. 4, Kati IV Tiranë; apo me e-mail në adresën competition@caa.gov.al.